

20160551444

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHOQATA DHE FONDACIONE

Neni 1

Në Ligin për shoqata dhe fonacione ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 52/10 dhe 135/11), në nenin 40 në paragrafin 2 fjalët: "në formë të shkruar dhe" shlyhen.

Neni 2

Në nenin 42 në paragrafin (1) pas fjalës "dorëzon" vihet presje dhe shtohen fjalët: "drejtpërdrejt, me postë ose në formë elektronike,".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Në fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni, përfaqësuesi nga paragrafi (2) i këtij neni do ta shënojë mënyrën në të cilën komunikon me institucionin, përkatësisht nëse do të komunikojë gojarisht, në formë të shkruar ose në formë elektronike.".

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Neni 3

Neni 43-a ndryshohet si vijon:

"Nëse regjistri me aktvendim e ka refuzuar kërkesën për lëshimin e aktvendimit, ose nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin e përcaktuar në nenin 43 paragrafi (1) i këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të Regjistrisë, përkatësisht pas skadimit të afatit nga neni 43 paragrafi (1) nga ky ligj në Komisionin Shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.".

Neni 4

Neni 43-b shlyhet.

Neni 5

Në nenin 46 në paragrafin (1) pas fjalës kërkesa vihet presje dhe shtohen fjalët: "drejtpërdrejt, me postë ose në formë elektronike,".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Në fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni, përfaqësuesi nga paragrafi (2) i këtij neni do ta shënojë mënyrën në të cilën komunikon me institucionin, përkatësisht nëse do të komunikojë gojarisht, në formë të shkruar ose në formë elektronike.".

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 6

Në nenin 76 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Shoqata ose fondacioni paraqet kërkesë për marrjen e statusit të organizatës me interes publik drejtpërdrejt, me postë ose në formë elektronike, në Komisionin për organizata me status me interes publik. Në kërkesë do ta cekë mënyrën në të cilin dëshiron të komunikojë me Komisionin, përkatësisht nëse do të komunikojë gojarisht, në formë të shkruar ose në formë elektronike.".

Në paragrafin (2) fjalët: "Me kërkesë dorëzohet edhe" zëvendësohen me fjalët: "Për marrjen e statusit të organizatës me interes publik janë të nevojshme këto dëshmi".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Drejtësisë që e udhëheq procedurës është i obliguar në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni t'i kërkojë provat nga paragrafi (2) alineja 1,11 dhe 12 të këtij neni nga organi kompetent publik.".

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

(4) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik prej të cilit janë kërkuar provat dhe të dhënat nga paragrafi (3) i këtij neni është i obliguar t'i dorëzojë provat e kërkuara dhe të dhënat në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.".

Paragrafi (4) bëhet paragraf (5).

Neni 7

Pas nenit 95 shtohet neni i ri 95-a, si vijon:

“Neni 95-a

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nëse nuk i kërkon provat me detyre zyrtare në afatin e përcaktuar në nenin 76 paragrafi (3) i këtij ligji.

Gjobë me shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar nga organi kompetent prej të cilit janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në nenin 76 paragrafi (4) të këtij ligji.

Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2) të këtij neni procedurë kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.”

Neni 8

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).